



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 1 i Regj. Themeltar
Nr. 1 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

**Ilir PANDA
Albana BOKSI
Klodian KURUSHI**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot, në datë 18.05.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Gentian Shahini (Pepa)

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 10-2021-293 (54), datë 23.02.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës

BAZA LIGJORE: Neni 417 e vijues i i Kodit të Procedurës Penale

Në çështjen penale me palë:

KËRKUES: Gentian Shahini (Pepa)

KUNDËR: Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës

OBJEKTI: Lirim me kusht

BAZA LIGJORE: Neni 64 i Kodit Penal

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N,

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi (i dënuari) Gentian Shahini (Pepa) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesën e tij, me objekt "Lirim me kusht", referuar nenit 64 të Kodit

Penal. Nga aktet në dosjen gjyqësore ka rezultuar e provuar se kërkuesi Gentian Shahini (Pepa), vuan dënimin me burgim në I.E.V.P. Lushnjë, burg i sigurisë së zakonshme.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2805, datë 24.10.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Vjedhje me arme" në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 140-25 i Kodit Penal duke e dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për lirim me kusht duke pretenduar se ka vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit, është i padënuar më parë, sjellja gjatë qëndrimit në burg ka qenë në përputhje me rregulloren dhe ka përfituar leje shpërblyese. Kërkuesi ka pretenduar se ka nënën të sëmure dhe ka përfituar një kontratë punësimi si shofer tek shoqëria "AGUSTIN 04", do të riintegrohet në shoqëri dhe do t'i përkushtohet familjes së tij.

3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 755, datë 26.12.2019**, ndër të tjera, ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës.*

Lirimin me kusht të kërkuesit, të dënuarit Gentian Halim Shahini (Pepa), nga vuajtja e mëtejshme e dënimit të mbetur të dhënë me vendimin nr. 2805 datë 24.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kusht që për 3 (tre) vjet, kohë që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale me dashje, duke filluar afati i kushtit nga data 26.12.2019."

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka arsyetuar se:

Së pari, i dënuari Gentian Halim Shahini (Pepa), referuar dinamikës së vuajtjes së dënimit, deri në datën e shqyrtimit të kësaj kërkesë ka plotësuar e vuajtjes së dënimit të dhënë (rezulton se deri në datë 26.12.2019, i dënuari Gentian Halim Shahini (Pepa) ka vuajtur 7 vjet e 11 muaj burgim dhe i kanë mbetur për të vuajtur nga dënimi i dhënë dhe 2 vjet e muaj burgim kur për të vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit të kishte vuajtur 7 vjet e 6 muaj, duke përmbushur një nga kushtet ligjore të lirimimit me kusht.

Së dyti, i dënuari sipas kësaj gjykate, ka provuar një kusht tjetër thelbësor që parashikon dispozita konkrete, neni 64 i Kodit Penal, për lirimin me kusht të të dënuarit, që është ekzistenca e "një arsyeje të veçantë" që justifikon pranimin e kësaj kërkesë. Si arsye të veçantë për lirimin me kusht në këtë rast, gjykata e shkallës së parë ka pranuar faktin se kërkuesi ka nënën e sëmure dhe të ve, jeton në kushte të vështira ekonomike, si dhe pas daljes nga burgu do të punësohet si shofer pranë një biznesi privat.

Së treti, i dënuari Gentian Halim Shahini (Pepa) referuar akteve provuese ka provuar para gjykatës se ai nuk është dënuar më parë për krime të kryera me dashje, kjo sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr.7, datë 25.07.2019 dhe nr.7, datë 19.12.2019, duke përmbushur në këtë rast një tjetër kusht ligjor i kërkuar nga neni 64 i Kodit Penal. Gjithashtu nuk rezulton të jetë dënuar për ndonjë nga veprat penale për të cilat nuk mund të përfitojë lirimin me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal.

5. **Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-293 (54), datë 23.02.2021**, ndër të tjera, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit penal nr. (13-2019-7776) 755, datë 26.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në këtë mënyrë:*

Rrëzimin e kërkesës së të dënuarit Gentian Shahini."

6. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se kushtet e kërkuara nga neni 64 i Kodit Penal në lidhje me lirimin me kusht duhet të përmbushen njëkohësisht. Gjykata e Apelit çmon se ashtu siç ka pretenduar dhe prokurori në ankim, kërkuesi nuk ka pasur sjellje të mirë gjatë vuajtjes së dënimit, përkundrazi ka shfaqur sjellje problematike dhe për këtë arsye është ndëshkuar me masa disiplinore për ushtrim të dhunës fizike dhe psikike ndaj të dënuarve të tjerë. Sjellja e të dënuarit në këtë rast vlerësohet jo për arsye të penalizimit të tij për herë të dytë, por për efekt të matshmërisë së rehabilitimit të tij, duke marrë parasysh edhe veprën penale shumë të rëndë për të cilën ai është dënuar, konkludohet se, në fazën kur është pranuar kërkesa nuk është arritur qëllimi i dënimit penal, rehabilitimi i kërkuesit. Prandaj, Gjykata e Apelit, ndryshe nga

sa ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, vlerëson se kërkuesi nuk plotëson kushtin e parë, të pasjes së një arsye të veçantë dhe sjelljen e tij të mirë në institucion.

7. **Kundër vendimit nr. 10-2021-293 (54) datë 23.02.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs, kërkuesi Gentian Shahini**, me anë të së cilit ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

8. **Kërkuesi Gentian Shahini, në datën 30.03.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 10-2021-293 (54) datë 23.02.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës**, duke parashtruar këto shkaqe:

- Kthimi i kërkesit Gentian Shahini në burg do t'i shkaktonte dëme të pariparueshme nënës së tij, e cila ka shumë nevojë për kujdesjen e tij. Nëna e tij është me këmbë të thyer dhe në gjendje shumë të rëndë ekonomike.
- Kërkuesi gjatë kësaj është detyruar të punojë në punë të zezë, duke punuar me furgonin e tij, për t'i ardhur në ndihmë nënës së tij.
- Gjatë kohës që kërkuesi ka qenë me lirim me kusht, është paraqitur rregullisht tek shërbimi i provës, është treguar korrekt në komunitet, duke mos kryer asnjë veprime në kundërshtim me ligjin. Kërkuesi nuk është burim rreziku për shoqërinë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa e kërkesit Gentian Shahini për pezullimin e vendimit penal nr. 10-2021-293 (54), datë 23.02.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës nuk është e bazuar në ligj.

10. Kolegji vë në dukje se kërkuesi e ka bazuar kërkesën për pezullim të vendimit penal në nenin 417 të Kodit të Procedurës Penale (dispozita në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës) që parashikon: *“Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.*

Ankimet kundër vendimeve që lidhen me lirinë personale nuk kanë efekt pezullues.”

11. Kjo dispozitë parashikon se vendimet penale të gjykatës së shkallës së parë ndaj të cilave është ushtruar ankim nuk ekzekutohen, deri në momentin që për to është shprehur gjykata e apelit. Vendimi i Gjykatës së Apelit është vendimi i ekzekutueshëm. Ky parim nuk zbatohet kur vendimi penal i referohet masave të sigurimit personal, pasi ai është i zbatueshëm që në momentin e shprehjes me vendim nga gjykata.

12. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se kërkuesi referon tek neni 417 i KPP, i cili para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, parashikonte: *“Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit ose të kërkesës për rishikim, vendimi mund të pezullohet me urdhër, përkatësisht, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor.”*

13. Kolegji Penal vlerëson se ligji procedural penal nuk e parashikon më institutin e pezullimit të vendimit gjyqësor penal, ndryshe nga neni 417 i Kodit para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, që i jepte të drejtë Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor që të vendoste pezullimin. Ligji procedural penal nuk parashikon të drejtën e Gjykatës së Lartë për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimeve penale, prandaj Kolegji vlerëson se kërkesa e kërkesit nuk gjen mbështetje ligjore.

14. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Gentian Shahini për pezullim të ekzekutimit të vendimit penal nuk ka bazë ligjore, ajo nuk gjen mbështetje të asnjë dispozitë procedurale penale, prandaj duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 417 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkesit Gentian Shahini për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 10-2021-293 (54), datë 23.02.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Tiranë, më 18.05.2021

A N Ë T A R

A N Ë T A R

K R Y E S U E S

Klodian KURUSHI

Albana BOKSI

Ilir PANDA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 2 i Regj. Themeltar
Nr. 2 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ilir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtare
Klodian KURUSHI	Anëtar

sot, në datë 18.05.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr.2-2021 Regj.Them, që i përket:

KËRKUES: Gaqo Mile

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë.

BAZA LIGJORE: Neni 449 dhe 454 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës Albana Boksi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1- Kërkuesi Gaqo Mile, nëpërmjet avokatit mbrojtës, ka paraqitur në Gjykatë të Lartë kërkesën nr. 2 Regj.Them, datë 22.05.2021, me objekt: “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë”. Në këtë kërkesë, kërkuesi referon se me vendimin gjyqësor me nr.(299) 125, datë 16.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i lënë në fuqi me vendimin 14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, ai është dënuar me 80’000 lek gjobë.

2- Në fakt rezulton se, me vendimin nr. (299) 125, datë 16.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i lënë në fuqi me vendimin 14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, kërkuesit i nuk i është pranuar ankimi ndaj vendimit të mosfillimit të

procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Pogradec, datë 26.11.2019, në lidhje me materialin kallëzues nr.704/2019, që ky i fundit ka depozituar pranë prokurorisë.

3- Kërkuesi (ankuesi) Gaqo Mile, pasi është njohur në datë 28.03.2021 me vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë, ka ushtruar rekurs, në datë 06.04.2021.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

4- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) evidenton se kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë të Lartë kërkesën nr. 2 Regj.Them, datë 22.05.2021, me objekt: “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë”. Në këtë kërkesë referon se me vendim gjyqësor me nr. (299) 125, datë 16.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i lënë në fuqi me vendimin 14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, kërkuesi është dënuar me 80’000 lek gjobë, duke pasqyruar si bazë ligjore nenin 449 dhe 454 të KPP.

5- Kolegji konstaton se baza ligjore që referon kërkuesi nuk është e duhura pasi ato përfshihen në KREU IV, RISHIKIMI, që i përket një instituti tjetër të procedurës penale dhe është kompetencë e gjykatave të faktit. Gjithashtu, kërkuesi referon se ai është dënuar me gjobë në masën prej 80’000 lek me vendimin me nr. (299) 125, datë 16.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i lënë në fuqi me vendimin 14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë. Por, nga aktet që i përket dosjes penale rezulton se, objekti i shqyrtimit të gjykatave të faktit ka qenë “*Kundërshtimi (anullimin) e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë 26.11.2019, të prokurorit Erion Pustina, në lidhje me materialin kallëzues nr.704/2019*” dhe jo dënim penal siç kërkuesi referon në kërkesën e tij për pezullimin e ekzekutimit.

6- Kolegji konstaton se, kërkuesi kërkon pezullimin e ekzekutimit, me pretendimin se ai në rekursin e depozituar ndaj vendimit nr. 14, datë 22.01.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, ka kërkuar kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, Gjykata e Apelit Korçë.

7- Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural, i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

8- Kolegji vlerëson të përmendë se sipas ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 1 gusht 2017, neni 417 “Pezullimi i ekzekutimit”, parashikon:

“1. Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Ankimet kundër vendimeve që lidhen me lirinë personale nuk kanë efekt pezullues.”

Ndërkohë që deri para këtyre ndryshimeve ligjore dispozita parashikonte se:

“1.Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit ose të kërkesës për rishikim, vendimi mund të pezullohet me urdhër, përkatësisht, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor. ...”

9. Në këto kushte, në zbatim të dispozitave të referuar, ky Kolegj e gjen kërkesën e paraqitur si të pabazuar në ligj dhe çmon se një kërkim i tillë nuk mund t’i drejtohet Gjykatës së Lartë, për shkak se ligji nuk e parashikon një mjet të tillë kërkimi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

- Mospranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesi Gaqo Mile, kundër vendimit Nr. 14, datë 22.01.2021, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Tiranë, më 18.05.2021

A N Ë T A R

A N Ë T A R E

K R Y E S U E S

Klodian KURUSHI

Albana BOKSI

Illir PANDA